AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP), TM2 2023

01. 09. 2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Çmimeve të Prodhimit (IÇP) për tremujorin e dytë (TM2) 2023.

Rënie e lehtë e çmimeve të prodhimit në TM2 2023

Indeksi i tërësishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë pësoj rënie për (-0,1%) në TM2 2023, krahasuar me TM1 2023. Ndërkaq, krahasuar TM2 2023 me TM2 2022 çmimet e prodhimit u ulën në një mesatare prej (-0,9%).



Tremujori i dytë 2023 / Tremujori i parë 2023 (-0,1%)

Çmimet e prodhimit në Kosovë pësuan rënie në një mesatare prej (-0,1% në TM2 2023, krahasuar me TM1 2023. Rënie më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: nxjerrja e xehes së metalit (-14,9%) dhe prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove (-13,2%).

Rënia u neutralizua me ngritjen e çmimeve te: energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (3,0%); prodhimi i letrës dhe produkteve prej saj (2,1%); prodhimi produkteve të lëkurës dhe produkteve prej saj (1.9%), etj.

© Agjencia e Statistikave të Kosovës 2023

Tremujori i dytë 2023 - Tremujori i dytë 2022 (-0,9%)

Çmimet e prodhimit në Kosovë pësuan rënie në një mesatare prej (-0.9%) në TM2 2023, krahasuar me TM2 2022. Rënie më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: nxjerrja e xehes së metalit (-14,9%) dhe energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (-12,9%).

Rënia u neutralizua nga ngritja e çmimeve te: xeheroret dhe guroret e tjera (21,1%); prodhimi i letrës dhe produkteve prej saj (20,4%); prodhimi i produkteve kimike (8,0%), etj.

Ndryshimet tremujore dhe vjetore në (%)

Kodet	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike NACE rev.2	Peshat	TM2 - 2023 Ø2010=100	TM2 - 2023 TM1 - 2023	TM2 - 2023 TM2 - 2022
	Gjithsej IÇP	1000.00	130.1	-0.1	-0.9
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	1.67	137.5	0.0	0.0
07	Nxjerrja e xehes së metalit	10.44	157.0	-14.9	-14.9
08	Xeherorët dhe guroret tjera	30.62	161.5	1.0	21.1
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	133.61	136.2	-1.0	5.7
11	Prodhimi i pijeve	56.57	110.9	-2.9	3.5
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1.16	0.0	0.0	0.0
13	Prodhimi i tekstilit	8.65	0.0	0.0	0.0
14	Prodhimi i veshjeve	5.46	0.0	0.0	0.0
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës	2.96	108.1	1.9	-3.9
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara - thurëse	20.86	116.0	-0.8	-1.4
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	12.54	105.0	2.1	20.4
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	9.82	0.0	0.0	0.0
20	Prodhimi i produkteve kimike	14.12	154.6	-0.2	8.0
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutike	1.51	0.0	0.0	0.0
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	72.85	112.5	-0.1	4.5
23	Prodhimi i produkteve minerale jometalike	137.89	108.9	-0.5	2.7
24	Prodhimi i metaleve	52.00	91.5	-3.4	-4.5
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve	61.53	102.3	1.2	1.0
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	7.75	118.1	0.0	1.2
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t	2.51	95.3	-3.1	3.9
30	Prodhimi i mjeteve motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove	0.67	125.7	-13.2	-5.2
31	Prodhimi i mobilieve	59.60	103.5	-0.7	1.4
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	4.69	0.0	0.0	0.0
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajr të kondicionuar	256.52	140.2	3.0	-12.9
36	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	16.91	113.8	0.0	4.6
38	Veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve	17.10	0.0	0.0	0.0

Për më shumë informata lidhur me Indeksin e Çmimeve të Prodhimit (IÇP) për TM2 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation

© Agjencia e Statistikave të Kosovës 2023